



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **“SHËRBIME ELEKTRO-AUTO”**

**Niveli III në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit III të KEK<sup>2</sup>**

**M3-III-22**

**Tiranë, 2022**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimit

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e kualifikimeve

<b>Emërtimi i kualifikimit</b>	<b>“Shërbime elektro-auto”</b>			
<b>Kohëzgjatja</b>	<b>900-1100 orë</b>	<b>Niveli</b>	<b>III në KSHK, referuar nivelit III të KEK</b>	<b>Kodi M3-III-22</b>
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi i kualifikimit profesional në profilin mësimor “Shërbime elektro-auto” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve elektrike dhe elektronike të mjeteve të transportit, si dhe të zhvillojë personalitetin e individve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në drejtimin “Shërbime elektro-auto” të nivelit të tretë në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme në drejtimin “Shërbime mjeteve transporti;</li> <li>- janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.</li> <li>- pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë e tyre.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime elektro-auto”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të nivelit, të punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të shërbimeve elektro-auto, në pika servisi elektro-auto të mjeteve të transportit, veprimtaritë e tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve të transportit, si dhe nëveprimtari të tjera që veprojnë në këtë drejtim.</p> <p>Me përfundimin e arsimit të profilit mësimor “Shërbime elektro-auto”, niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin IV të KSHK, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/manaxherial) të kualifikimit profesional (njëvjeçar) të drejtimit mësimor “Shërbime mjeteve transporti” dhe fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
<b>Data e validimit</b>				
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet mëparshme</b>	<b>M-II-03-11, M3-III-18</b>			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

**Rezultatet e të nxënit në:**

## **NJOHURI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin mësimor “Shërbime elektro-auto” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

### **Organizimi dhe përgatitja e vendit të punës në shërbimet elektro-auto në mjetet e transportit**

- Të tregojë rëndësinë e shërbimeve elektro-auto;
- Të klasifikojë shërbimet elektro-auto;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e një servisi për shërbimet elektro-auto;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit dhe sistemimit të vendit të punës, sipas standardeve;
- Të përshkruajë organizimin dhe ndarjen e punës në një servis për shërbimet elektro-auto;
- Të shpjegojë rëndësinë e konsultimit me teknikët dhe grupet e tjera të punës;
- Të përshkruajë hapat për sigurimin e bazës materiale për shërbimet elektro-auto;
- Të shpjegojë mënyrën e organizimit dhe monitorimit të shërbimeve elektro-auto;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit teknik për gatishmërinë e mjeteve të punës;

### **Veprat, pajisjet dhe instrumentet matëse e kontrolluese në shërbimet elektro-auto, në mjetet e transportit**

- Të listojë veglat, pajisjet dhe instrumentet matëse e kontrolluese në një servis elektro-auto, sipas përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit për funksionalitetin e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve matëse e kontrolluese të punës;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të veglave, pajisjeve dhe instrumenteve matëse dhe kontrolluese sipas manualit të prodhuesit;
- Të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve dhe instrumenteve matëse e kontrolluese në servis;
- Të listojë materialet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të punës.

### **Kontrolli paraprak i sistemeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit**

#### ***Të përgjithshme:***

- Të përshkruajë rëndësinë e kontrolleve paraprake në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të argumentojë rëndësinë dhe procedurat e kontrollit paraprak të elementëve të sistemeve kompjuterike (sensorët, modulet dhe vepruesit);;
- Të listojë llojet e kontrolleve paraprake të sistemeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e matjes së parametrave elektrike me përdorimin e instrumenteve matëse përkatëse
- Të krahasojë vlerat e matura me vlerat nominale, sipas manualit të prodhuesit;

- Të përshkruajë rëndësinë e marrjes së informacionit nga burime të ndryshme;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të kontakteve dhe përcjellësve elektrike në panelin e instrumenteve të mjeteve të transportit;

***Në sistemin e furnizimit me energji elektrike:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të baterisë në motorët me djegie të brendshme;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të baterisë në mjetet elektrike të transportit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të alternatorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të kontakteve dhe përcjellësve elektrike në qarkun e karikimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të rregullatorit të tensionit (siguresa);

***Në sistemin e lëshimit të motorit:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak në kontaktet dhe përcjellësit elektrikë të sistemit të lëshimit të motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të çelësit të lëshimit të motorit (çelësi i ndezjes);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të motorinos, siguresës mbrojtëse dhe karbonçinave;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të elektromagnetit/releja e lëshimit;
- Të shpjegojë procedurat e kontrollit të funksionimit të sistemit të lëshimit, nëpërmjet lëshimit të motorit;

***Në sistemin e ndezjes së përzierjes djegëse:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak në elementet elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë në sistemin e ndezjes;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak në elementet elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë në sistemin e injektimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të siguresës mbrojtëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak në kontaktet dhe përcjellësit elektrikë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të fijeve/shiritave të kandeleve dhe të kandeleve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të kandeletave;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të bobinës induktive/bobina e ndezjes;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të procesit të sinkronizimit të flakërimit në sistemet elektronike me dhe pa distributor;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të këndit të avancës së dhënies së shkëndijës elektrike;

***Në sistemin e ndriçimit dhe sinjalizimit:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak në sistemet inteligjente të ndriçimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik në mekanizmat komandues të sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik

në fenerët e ndriçimit (dritat e shkurtra dhe të gjata), në sinjalet e drejtimit, në dritat e pozicionit, në fenerët e mjegullës etj.;

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik në dritat e marshit të pasmë, në panelin e instrumenteve të kabinës dhe sistemin e sinjalizimit të brendshëm;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemit të sinjaleve zanore.

#### ***Në sistemet ndihmëse:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik për hapjen/mbylljen e dyerve dhe të xhamave në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të sensorit të presionit të vajit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të treguesit të nivelit të lëndës djegëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të treguesit të temperaturës të sistemit të ftohjes;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të funksionimit të fshirëseve të xhamave dhe fenerëve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemit të ajrit të kondicionuar të kabinës.
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të sistemeve elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sigurisë në lëvizje të mjetit (kamera, sensori i distancës, presioni i gomave, etj.)

#### ***Në sistemet përbërës me komandim elektronik të mjetit të transportit:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të furnizimit me ajër;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të injektimit të lëndës djegëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të pompës elektrike të furnizimit me lëndë djegëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të elementeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike të pedalit të gazit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të elementëve elektrike, elektronike dhe kompjuterike të sistemit të shkarkimit të produkteve të djegies;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të modulit të transmisionit të fuqisë TCM (Transmission Control Module);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik në përforcuesin elektrik të timonit EPS (Elektronik Poëer Steering);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemit kundër bllokimit të frenave ABS ( Anti-lock Braking System )

#### **Punime (çmontim/montim, riparim dhe/ose zëvendësim) në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit**

##### ***Të përgjithshme:***

- Të përshkruajë skemat, bllok-skemat, ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike të automjetit dhe të përbërësve të tij;
- Të listojë llojet e punimeve në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike;

- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të standardeve, sipas manualeve të prodhuesit për punime në sistemet elektrike dhe elektronike dhe kompjuterike;
- Të përshkruajë rëndësinë e marrjes së informacionit nga burime të ndryshme për punime në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e shkëputjes dhe rivendosjes së lidhjeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike në sistemet e mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e shkëputjes dhe rivendosjes së lidhjeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike nga ato mekanike, hidraulike, pneumatike etj;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e zëvendësimit të elementeve të pjesëve elektrike elektronike dhe kompjuterike;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e riparimit me saldim (ngjitje me kallaj), me bashkues të kthyeshëm, bashkues të fabrikuar, me pajisjet dhe mjetet përkatëse të lidhjeve elektrike;
- Të përshkruajë procedurat e pastrimit të elementëve elektrikë me mjetet dhe materialet përkatëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe programet përkatëse të përzgjedhjes së pjesëve, materialeve për zëvendësim sipas kodeve përkatëse;
- Të përshkruajë mënyrën e plotësimit të dokumentacioni teknik për punimet në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike

#### ***Në sistemin e furnizimit me energji elektrike***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në baterinë e motorit me djegie të brendshme;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në baterinë dhe elementët e lidhur me të, në mjetet elektrike të transportit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në kontaktet dhe përcjellësit elektrikë të alternatorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në panelin e diodave të alternatorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e karbonçinave të alternatorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e rregullatorit të tensionit (siguresa);
- Të përshkruajë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera,

#### ***Në sistemin e lëshimit të motorit:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në kontaktet dhe përcjellësit elektrikë të sistemit të lëshimit të motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në çelësin e lëshimit të motorit (çelësi i ndezjes);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e siguresës dhe karbonçinave të motorinos;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elektromagnet/rele lëshimi;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në pështjellat dhe kolektorin e rotorit të motorinos;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në pështjellat e statorit të motorinos;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

#### ***Në sistemin e ndezjes së përzierjes djegëse:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në kontaktet dhe përcjellësit elektrikë;

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në kandelet dhe në fijet/shiritat e kandeleve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në kandeleta;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në bobinën induktive;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në distributorin mekanik/elektronik;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për regjistrimin e këndit të avancës së dhënies së shkëndijës elektrike;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

***Në sistemin e ndriçimit dhe të sinjalizimit:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemeve inteligjente të ndriçimit dhe sinjalizimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në mekanizmat komandues të sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në përcjellësit elektrikë, llambat, sinjalizuesit zanorë (boritë), çelësat dhe reletë e komandimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në fenerët e ndriçimit në automjet;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sinjalet e drejtimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në dritat e pozicionit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në dritat e marshit të pasmë të automjetit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sistemin e ndriçimit të brendshëm;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në panelin e instrumenteve të kabinës;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

***Në sistemet ndihmëse:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik për hapjen/mbylljen e dyerve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të hapjes/mbylljes së xhamave;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të sistemit elektrik të ngrohjes së xhamit të pasmë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të fshirëseve të xhamave dhe fenerëve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të komandimit të fenerëve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të komandimit të pasqyrave;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të komandimit të ndenjësive;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të ajrit të kondicionuar të kabinës;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemeve të sigurisë në lëvizje të mjetit (kamera, sensori i distancës, presioni i gomave, etj.) ;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të hapjes së jastëkëve të ajrit në rast aksidenti (AIRBAG) ;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në aparatet radio-CD dhe pajisjeve të tjera

ndihmëse;

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të zëvendësimit të treguesit të nivelit të lëndës djegëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të zëvendësimit të sensorit të presionit të vajit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të zëvendësimit të sensorit të temperaturës të sistemit të ftohjes;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të sistemit të furnizimit me energji elektrike të pajisjeve të tërhequra;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

***Në sistemet përbërës me komandim elektronik të mjetit të transportit:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sistemin elektrik, elektronik dhe kompjuterik të furnizimit me ajër;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sistemin elektrik, elektronik dhe kompjuterik të injektimit të lëndës djegëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në pompën elektrike të furnizimit me lëndë djegëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemit elektrik/elektronik të injektorëve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të pedalit të gazit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të shndërruesit katalitik të produkteve të djegies;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të valvulës së riqarkullimit të produkteve të djegies EGR (Exhaust Gas Recirculation);
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të sensorit të oksigjenit (sonda  $\lambda$ );
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të turbokompresorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të sistemit të avujve të lëndës djegëse;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e punimeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike në modulën e transmisionit të fuqisë TCM (Transmission Control Module);
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e punimeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mekanizmat e komandimit të transmisionit të fuqisë TCM (Transmission Control Module);
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e punimeve në modulën e kontrollit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të hidrotransformatorit në kutitë automatike të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë në sistemin e drejtimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në përforcuesin elektrik të timonit EPS (Elektronik Power Steering);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në motorin elektrik dhe sensorët e këndit të kthimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike në sistemin e frenimit;



- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sistemet e frenimit elektro-hidraulik EHB dhe elektromagnetik EMB;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sistemet e frenimit elektrik të emergjencës dhe të parkimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë në sistemin kundër bllokimit të frenave ABS ( Anti-lock Braking System );
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sensorin e shpejtësisë së rrotës;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sistemin e proporcionalitetit të presionit të frenave të pasme DRP (Dynamic Rear Proportioning);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sistemin e performancës së mjetit gjatë frenimit TCS (Traction Control System) dhe ESC (Electronic stability control);
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

### **Shërbime të mirëmbajtjes në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit**

- Të shpjegojë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike dhe rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e marrjes së informacionit nga manualët e prodhuesit për shërbimet e mirëmbajtjes në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të shpjegojë mënyrën e marrjes së informacioni nga burime të ndryshme për shërbimet e mirëmbajtjes në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të shpjegojë rëndësinë e shërbimeve periodike në mirëmbajtjen e sistemeve elektrike elektronike dhe kompjuterike në varësi të përdorimit (km, orë pune, etj.);
- Të përshkruajë procedurat e e mirëmbajtjes në kontaktet dhe përcjellësit elektrikë;
- Të përshkruajë llojet e pastrimeve, mjetet dhe materialet përkatëse për mirëmbajtjen e sistemeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes për regjistrime të elementeve në sistemet elektrike;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes për gratim me materialet përkatëse të elementeve në sistemet elektrike;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes së baterisë në motorin me djegie të brendshme;
- Të përshkruajë procedura e mirëmbajtjes së baterisë në mjetet elektrike të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes së alternatorit;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes së motorinos;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes së distributorit të sistemit të ndezjes;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në elementët e sistemin të ndriçim-sinjalizimit;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë në sistemin e frenimit me ABS ( Anti-lock Braking System);
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në elementët e sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemit të ajrit të kondicionuar të kabinës;

### **Bazat e sipërmarrjes dhe edukim karriere**

- Të përshkruajë rolin, rëndësinë dhe sipërmarrjen me të gjithë elementet kryesore të saj;
- Të përshkruajë veçoritë e mjedisit social, ekonomik ku zhvillohet sipërmarrja e biznesit;
- Të përshkruajë ndikimin e sipërmarrjes në biznes;
- Të listojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;

- Të përshkruajë nevojat dhe mënyrat e plotësimit të kërkesave të klientëve;
- Të përshkruajë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes;
- Të përshkruajë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të shpjegojë detyrimet tatimore, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën që lidhet me aktivitetin e kryer;
- Të shpjegojë mënyrën e hartimit të planeve ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të shpjegojë shërbime të thjeshta me bankë lidhur me aktivitetin e biznesit;
- Të përshkruajë përgatitjen e raporteve periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët, në regjistrat e duhur;
- Të listojë llojet e dixhitalizimit të pagesave dhe ndikimin që sjellin ato në zhvillimin e aktivitetit të një biznesi;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të çmimit të tregut lidhur me materialet, pajisjet e punës dhe pjesët e këmbimit, si dhe për shërbimet e kryera;
- Të shpjegojë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me koston e materialeve të punës pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të kryera;
- Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të burimeve njerëzore sipas proceseve dhe ngarkesës së punës;
- Të interpretojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në pjesët elektrike, elektronike dhe kompjuterike të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë mënyrën e dorëzimit të dokumentacionit teknik dhe financiar të shërbimeve të kryera për klientin;
- Të përshkruajë rëndësinë e përditësimit të njohurive për aplikimin e teknikave/ teknologjive të reja në punë;
- Të përshkruajë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;

#### **Komunikimi dhe etika**

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe teknikat përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të TIK dhe teknologjive të reja të komunikimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e shkëmbimit të informacionit mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të përshkruajë parimet dhe domosdoshmërinë e punës në grup;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të hierarkisë;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale gjatë komunikimit me kolegët dhe klientët;
- Të përshkruajë Kodin e Etikës, rëndësinë e zbatimit të tij;
- Të përshkruajë mënyrat e menaxhimit të ankesave dhe mosmarrëveshjeve me klientët;
- Të përshkruajë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;

#### **Rregullat e sigurisë, shëndetit në punë. mbrojtja e mjedisit**

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe

dokumentacionin e detyrueshëm;

- Të përshkruajë manualët e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas Standardit në fuqi;
- Të përshkruajë masat për garantimin e sigurisë dhe shëndetin në punë;
- Të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë së kryerjes së shërbimeve elektro-auto të mjeteve të transportit duke shpjeguar mënyrën e shmangies së tyre;
- Të listojë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të shpjegojë sinjalistikën (udhëzimet, shenjat dhe simbolet e shkruara) të vendosura në mjediset e punës dhe rëndësia ezbatimit të tyre;
- Të përshkruajë planin dhe procedurat e evakuimit në raste emergjence;
- Të përshkruajë rregullat e parandalimit dhe mbrojtjes nga zjarri në vendin e punës;
- Të përshkruajë rreziqet nga zjarri, që vijnë nga ambientet me gaz, nga energjia elektrike, nga materialet ndezëse (shkrepëse, çakmakë, etj.);
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë ngritjes dhe zhvendosjes së ngarkesave dhe peshave të rënda;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme etj.;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materiale të ndryshme (vaj, alkool, lëndë djegëse, solucionet kimike etj.);
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me gaz;
- Të përshkruajë parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të përshkruajë procedurat e duhura për ndarjen e mbeturinave sipas llojit dhe depozitimin e mbetjeve nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që shkaktojnë ndotjen e mjedisit;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për ruajtjen e tij;
- Të përshkruajë llojet e tabelave të sigurisë teknike dhe rrethimin e objektit
- Të përshkruajë zbatimin e protokolleve të duhura në raste pandemie;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit racional të materialeve të lëndëve të para, veglave të këmbimit dhe të energjisë së përdorur;

**Rezultatet e të nxënit në:**

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin mësimor “Shërbime elektro-auto” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë shprehinë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

### **Organizimi dhe përgatitja e vendit të punës në shërbimet elektro-auto në mjetet e transportit**

- Të organizojë vendin e punës për shërbimet elektro-auto të mjeteve të transportit;
- Të zbatojë standardet e profesionit të elektroautit;
- Të interpretojë dokumentacionin teknik për punimet elektro-auto në automjet;
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet e duhura sipas proceseve të punës për shërbime elektro-auto;
- Të hartojë një preventiv paraprak për punime elektro-auto;

- Të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet elektro-auto;
- Të konsultohet me teknikët dhe grupet e tjera të punës;
- Të zbatojë mënyrën e planifikimit, organizimit dhe monitorimit të veprimtarisë;
- Të zbatojë veprimtaritë sipas planifikimit ditor, mujor, etj. dhe prioriteteve;
- Të kryejë veprimet për sigurimin e bazës materialo-teknike për shërbimet elektroauto;
- Të përzgjedhë materialet që përdoren në shërbimet elektroauto sipas përdorimit të tyre;
- Të zbatojë procedurat për vendosjen e mjetit në vendin e kontrollit për shërbimet elektro-auto;
- Të zbatojë procedurat/rregullat për pranimin e mjetit për kontroll paraprak;
- Të zbatojë rregullat e kontrollit dhe sigurimit të gjendjes teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës për shërbimet elektro-auto;
- Të zbatojë radhën e punës për realizimin e punimeve;

### **Veglat, pajisjet dhe instrumentet matëse e kontrolluese në shërbimet elektro-auto, në mjetet e transportit**

- Të përzgjedhë veglat, pajisjet e punës dhe instrumentet matëse dhe kontrolluese sipas funksionit të tyre;
- Të përdorë veglat, pajisjet e punës dhe instrumentet matëse në një servis për shërbimet elektroauto, sipas manualit të prodhuesit;
- Të përzgjedhë materialet e duhura për pastrimin dhe mirëmbajtjen e veglave, të pajisjeve të punës dhe instrumentet matëse;
- Të mirëmbajë veglat, pajisjet e punës dhe instrumentet matëse në një servis për shërbimet elektro-auto;
- Të zbatojë manualin e përdorimit të mjeteve të punës dhe pajisjeve ndihmëse në një servis për shërbimet elektro-auto;

### **Kontrolli paraprak i sistemeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit** ***Të përgjithshme:***

- Të parapërgatitë vendin e punës dhe automjetin për të mundësuar kontrollin paraprak të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të tij;
- Të identifikojë parregullsitë në sistemet elektrik, elektronike dhe kompjuterike nëpërmjet sinjaleve në panelin e instrumenteve;
- Të interpretojë funksionimin e skemave të ndryshme elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të realizojë lidhjen/shkëputjen e pajisjes lexuese (scan tool) me sistemin kompjuterik të automjetit;
- Të përdorë dokumentacionin teknik të automjetit sipas manualeve të prodhuesit;
- Të zbatojë procedurat e kontroleve paraprake në sistemet elektrik, elektronike dhe kompjuterike, duke përdorur pajisjet përkatëse;
- Të kryejë matjet dhe kontrollet me anën e pajisjeve përkatëse, në qarqet elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të interpretojë vlerat e matura me referencat e manualit të prodhuesit;
- Të përcaktojë (lokalizojë) parregullsitë në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të zgjedhë mënyrën më ekonomike dhe ekologjike të riparimit

### ***Në sistemin e furnizimit me energji elektrike:***

- Të realizojë kontrollin paraprak të baterisë në motorët me djegie të brendshme;
- Të realizojë kontrollin paraprak të baterisë në mjetet elektrike të transportit;

- Të realizojë kontrollin t paraprak të alternatorit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të kontakteve dhe përcjellësive elektrikë në qarkun e karikimit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të rregullatorit të tensionit (siguresa);

***Në sistemin e lëshimit të motorit:***

- Të realizojë kontrollin paraprak në kontaktet dhe përcjellësit elektrikë të sistemit të lëshimit të motorit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të çelësit të lëshimit të motorit (çelësi i ndezjes);
- Të realizojë kontrollin paraprak të motorinos, siguresës mbrojtëse dhe karbonçinave;
- Të realizojë kontrollin paraprak të elektromagnetit / releja e lëshimit;
- Të realizojë kontrollin e funksionimit të sistemit të lëshimit, nëpërmjet lëshimit të motorit;

***Në sistemin e ndezjes së përzierjes djegëse:***

- Të realizojë kontrollin paraprak në elementet elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë në sistemin e ndezjes;
- Të realizojë kontrollin paraprak në elementet elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë në sistemin e injektimit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të siguresës mbrojtëse;
- Të realizojë kontrollin në kontaktet dhe përcjellësit elektrikë ;
- Të realizojë kontrollin paraprak të fijeve/shiritave të kandeleve dhe të kandeleve;
- Të realizojë kontrollin paraprak të kandeletave;
- Të realizojë kontrollin paraprak të bobinës induktive / bobina e ndezjes;
- Të realizojë kontrollin paraprak të procesit të sinkronizimit të flakërimit në sistemet elektronike me dhe pa distributor;
- Të realizojë kontrollin paraprak të këndit të avancës të dhënies së shkëndijës elektrike;

***Në sistemin e ndriçimit dhe sinjalizimit:***

- Të realizojë kontrollin paraprak në sistemet inteligjente të ndriçimit
- Të realizojë kontrollin paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik në mekanizmat komandues të sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimit;
- Të realizojë kontrollin paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik në fenerët e ndriçimit , në sinjalet e drejtimit, në dritat e pozicionit, në fenerët e mjegullës etj.;
- Të realizojë kontrollin paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik në dritat e marshit të pasmë, në panelin e instrumenteve të kabinës dhe sistemin e sinjalizimit të brendshëm;
- Të realizojë kontrollin paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemit të sinjaleve zanore.

***Në sistemet ndihmëse:***

- Të realizojë kontrollin paraprak të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik për hapjen/mbylljen e dyerve dhe të xhamave në mjetet e transportit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të sensorit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të presionit të vajit;
- Të realizojë kontrollin paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të treguesit të nivelit të lëndës djegës;
- Të realizojë kontrollin paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të treguesit të temperaturës të sistemit të ftohjes;
- Të realizojë kontrollin paraprak të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të funksionimit të fshirëseve të xhamave dhe fenerëve;

- Të realizojë kontrollin paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemit të ajrit të kondicionuar të kabinës.
- Të realizojë kontrollin paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemeve të sigurisë në lëvizje të mjetit (kamera, sensori i distancës, presioni i gomave, etj.)

***Në sistemet përbërës me komandim elektronik të mjetit të transportit:***

- Të realizojë kontrollin paraprak të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të furnizimit me ajër;
- Të realizojë kontrollin paraprak të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të injektimit të lëndës djegëse;
- Të realizojë kontrollin paraprak të pompës elektrike të furnizimit me lëndë djegëse;
- Të realizojë kontrollin paraprak të elementeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike të pedalit të gazit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të elementëve elektrike, elektronike dhe kompjuterike të sistemit të shkarkimit të produkteve të djegies;
- Të realizojë kontrollin paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të modulit të transmisionit të fuqisë TCM (Transmission Control Module);
- Të realizojë kontrollin paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik në përforcuesin elektrik të timonit EPS (Elektronik Poëer Steering);
- Të realizojë kontrollin paraprak elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemit kundër bllokimit të frenave ABS ( Anti-lock Braking System )

**Punime (çmontim/montim, riparim dhe/ose zëvendësim) në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit**

***Të përgjithshme:***

- Të interpretojë skemat, bllok-skemat e sistemeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike të automjetit;
- Të përcaktojë llojet e punimeve në sistemet elektrike elektronike dhe kompjuterike;
- Të zbatojë standardet sipas manualeve të prodhuesit për punime në sistemet elektrike dhe elektronike dhe kompjuterike;
- Të vlerësojë marrjen e informacionit nga burime të ndryshme për punime në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të realizojë shkëputjen dhe rivendosjen e lidhjeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike në sistemet e mjeteve të transportit
- Të realizojë shkëputjen dhe rivendosjen e lidhjeve elektrike-elektronike dhe kompjuterike nga ato mekanike, hidraulike, pneumatike etj.;
- Të realizojë zëvendësimin e elementeve të pjesëve elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të realizojë riparimin me saldim (ngjitje me kallaj) me bashkues të kthyeshëm, bashkues të fabrikuar duke përdorur pajisjet dhe mjetet përkatëse të lidhjeve elektrike;
- Të realizojë pastrimin e elementëve elektrikë me mjetet dhe materialet përkatëse;
- Të realizojë përzgjedhjen e pjesëve dhe materialeve për zëvendësim sipas kodeve përkatëse;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet në sistemet elektrike elektronike dhe kompjuterike sipas programeve tip që aplikojnë serviset e riparimit të mjeteve të transportit;
- Të përdorë programet e servisit për pjesët e këmbimit.

***Në sistemin e furnizimit me energji elektrike:***

- Të realizojë punime në baterinë e motorit me djegie të brendshme;
- Të realizojë punime në baterinë dhe elementët e lidhur me të, në mjetet elektrike të transportit;
- Të realizojë punime në kontaktet dhe përcjellësit elektrikë të alternatorit;
- Të realizojë punime në panelin e diodave të alternatorit;
- Të realizojë punime për zëvendësimin e karbonçinave të alternatorit;
- Të realizojë punime për zëvendësimin e rregullatorit të tensionit (siguresa);
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

***Në sistemin e lëshimit të motorit:***

- Të realizojë punime në kontaktet dhe përcjellësit elektrikë të sistemit të lëshimit të motorit;
- Të realizojë punime në çelësin e lëshimit të motorit (çelësi i ndezjes);
- Të realizojë punime për zëvendësimin e siguresës dhe karbonçinave të motorinos;
- Të realizojë punime në elektromagnet/rele lëshimi;
- Të realizojë punime në pështjellat dhe kolektorin e rotorit të motorinos;
- Të realizojë punime në pështjellat e statorit të motorinos;
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

***Në sistemin e ndezjes së përzierjes djegëse:***

- Të realizojë punime në kontaktet dhe përcjellësit elektrikë;
- Të realizojë punime në kandelet dhe në fijet/shiritat e kandeleve;
- Të realizojë punime në kandeleta;
- Të realizojë punime në bobinën induktive;
- Të realizojë punime në distributorin mekanik / elektronik;
- Të realizojë punime për regjistrimin e këndit të avancës së dhënies së shkëndijës elektrike;
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

***Në sistemin e ndriçimit dhe të sinjalizimit:***

- Të realizojë punime në elementët e sistemeve inteligjente të ndriçimit dhe sinjalizimit;
- Të realizojë punime në mekanizmat komandues të sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimit;
- Të realizojë punime në përcjellësit elektrikë, llambat, sinjalizuesit zanorë (boritë), çelësat dhe reletë e komandimit;
- Të realizojë punime në fenerët e ndriçimit në automjet;
- Të realizojë punime në sinjalet e drejtimit;
- Të realizojë punime në dritat e pozicionit;
- Të realizojë punime në dritat e marshit të pasmë të automjetit;
- Të realizojë punime në sistemin e ndriçimit të brendshëm;
- Të realizojë punime në panelin e instrumenteve të kabinës;
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

***Në sistemet ndihmëse:***

- Të realizojë punime të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të hapjes/mbylljes së dyerve;
- Të realizojë punime të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të hapjes/mbylljes së xhamave;
- Të realizojë punime të sistemit elektrik të ngrohjes së xhamit të pasmë;
- Të realizojë punime të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të fshirëseve të xhamave dhe fenerëve;

- Të realizojë punime të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të komandimit të fenerëve;
- Të realizojë punime të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të komandimit të pasqyrave;
- Të realizojë punime të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të komandimit të ndenjësive;
- Të realizojë punime të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të ajrit të kondicionuar të kabinës;
- Të realizojë punime të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemeve të sigurisë në lëvizje të mjetit (kamera, sensori i distancës, presioni i gomave, etj.);
- Të realizojë punime të sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të hapjes së jastëkëve të ajrit në rast aksidenti (AIRBAG);
- Të realizojë punime në aparatet radio-CD dhe pajisje të tjera ndihmëse;
- Të realizojë punime të zëvendësimit të treguesit të nivelit të lëndës djegëse;
- Të realizojë punime të zëvendësimit të sensorit të presionit të vajit;
- Të realizojë punime të zëvendësimit të sensorit të temperaturës të sistemit të ftohjes;
- Të realizojë punime të sistemit të furnizimit me energji elektrike të pajisjeve të tërhequra;
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

***Në sistemet përbërës me komandim elektronik të mjetit të transportit:***

- Të realizojë punime në sistemin elektrik, elektronik dhe kompjuterik të furnizimit me ajër;
- Të realizojë punime në sistemin elektrik, elektronik dhe kompjuterik të injektimit të lëndës djegëse;
- Të realizojë punime në pompën elektrike të furnizimit me lëndë djegëse;
- Të realizojë punime në elementët e sistemit elektrik/elektronik të injektorëve;
- Të realizojë punime në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të pedalit të gazit;
- Të realizojë punime në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të shndërruesit katalitik të produkteve të djegies;
- Të realizojë punime në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të valvulës së riqarkullimit të produkteve të djegies EGR (Exhaust Gas Recirculation);
- Të realizojë punime në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të sensorit të oksigjenit (sonda  $\lambda$ );
- Të realizojë punime në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të turbokompresorit;
- Të realizojë punime në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të sistemit të avujve të lëndës djegëse;
- Të realizojë punime elektrike, elektronike dhe kompjuterike në modulën e transmisionit të fuqisë TCM (Transmission Control Module);
- Të realizojë punime elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mekanizmat e komandimit të transmisionit të fuqisë TCM (Transmission Control Module);
- Të realizojë punime elektrike, elektronike dhe kompjuterike në hidrotransformatorin e kutive automatike të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të realizojë punime në elementët elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë të sistemit të drejtimit;
- Të realizojë punime në përforcuesin elektrik të timonit EPS (Elektronik Power Steering);
- Të realizojë punime në motorin elektrik dhe sensorët e këndit të kthimit;
- Të realizojë punime elektrike, elektronike dhe kompjuterike në sistemin e frenimit;
- Të realizojë punime në sistemet elektrike të frenimit elektrohidraulik EHB dhe elektromagnetik EMB;
- Të realizojë punime në sistemet e frenimit elektrik të emergjencës dhe të parkimit;
- Të realizojë punime elektrike, elektronike dhe kompjuterike në sistemin kundër bllokimit të



frenave ABS ( Anti-lock Braking System );

- Të realizojë punime në sensorin e shpejtësisë së rrotës;
- Të realizojë punime elektrike, elektronike dhe kompjuterike në sistemin e proporcionalitetit të presionit të frenave të pasme DRP (Dynamic Rear Proportioning);
- Të realizojë punime elektrike, elektronike dhe kompjuterike në sistemet e performancës së mjetit gjatë fazës së frenimit TCS (Traction Control System) dhe ESC (Electronic Stability Control);
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

### **Shërbime të mirëmbajtjes në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit**

- Të përcaktojë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes aktuale që duhet të kryhen në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të vlerësojë informacionin për shërbimet e mirëmbajtjes në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të zbatojë procedurat e përcaktuara nga manualët e prodhuesit për shërbimet e mirëmbajtjes në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të realizojë shërbimet periodike në mirëmbajtjen e sistemeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike në varësi të përdorimit (km, orë pune, etj.);
- Të realizojë mirëmbajtjen e kontakteve dhe përcjellësit elektrikë;
- Të realizojë pastrime me mjetet dhe materialet përkatëse për mirëmbajtjen e sistemeve elektrike, elektronike dhe kompjuterike;
- Të kryejë regjistrime të elementeve në sistemet elektrike;
- Të kryejë grasatime me materialet përkatëse të elementeve në sistemet elektrike;
- Të zbatojë procedurat e përcaktuara për mirëmbajtjen e baterisë në motorin me djegie të brendshme;
- Të kryejë matje dhe kontrole të nevojshme (matje të parametrave elektrike me multimetër dhe instrumente të tjera të avancuara, matje të densitetit të elektrolitit të baterisë etj.);
- Të plotësojë ose të zëvendësojë elektrolitin e baterisë;
- Të realizojë mirëmbajtjen e baterisë në mjetet elektrike të transportit;
- Të realizojë mirëmbajtjen e alternatorit;
- Të realizojë mirëmbajtjen e motorinos;
- Të realizojë mirëmbajtjen e elementëve të sistemit të ndezjes;
- Të zbatojë procedurat e përcaktuara për mirëmbajtjen e elementëve elektrikë, elektronikë dhe kompjuterikë në sistemin e frenimit me ABS ( Anti-lock Braking System);
- Të zbatojë procedurat e mirëmbajtjes në elementët e sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemit të ajrit të kondicionuar të kabinës;
- Të kryejë regjistrimet pajisjeve dhe komponentëve në sistemin elektrik-elektronik të mjeteve të transportit;
- Të regjistrojë shtrëngimin e rripit të alternatorit;
- Të regjistrojë pozicionet e ndriçuesve kryesorë;

### **Bazat e sipërmarrjes dhe edukim karriere**

- Të plotësojë nevojat dhe kërkesat e klientëve në shërbimet elektro-auto;
- Të përzgjedhë institucionet financiare për biznes;
- Të zbatojë detyrimet tatimore, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën që lidhet me aktivitetin

e kryer;

- Të hartojë plane ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të kryejë shërbime të thjeshta me bankë lidhur me aktivitetin e biznesit;
- Të përgatitë raporte periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të kryejë regjistrime të të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët, në regjistrat e duhur;
- Të përdorë llojet e dixhitalizimit të pagesave sipas ndikimit që sjellin ato në zhvillimin e aktivitetit të biznesit;
- Të kontrollojë tregun lidhur me cilësinë dhe çmimet për materialet, pajisjet e punës dhe pjesët e këmbimit, si dhe për shërbimet e kryera;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me koston e materialeve të punës pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të kryera;
- Të përgatisë një oferte për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në pjesët elektrike, elektronike dhe kompjuterike të mjeteve të transportit;
- Të aplikojë teknikave/teknologjive të reja në veprimtarinë e vet;
- Të përdorë mjete dhe mënyra të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve të biznesit;
- Të planifikojë burimet njerëzore sipas proceseve dhe ngarkesës së punës.

#### **Komunikimi dhe etika**

- Të zbatojë teknikat përkatëse të komunikimit;
- Të përdorë TIK dhe teknologji të reja të komunikimi;
- Të informojë mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të komunikojë me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës, duke pranuar mendimin kritik;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;
- Të respektojë shkallën e hierarkisë në organizatë;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të përdorë terminologjinë profesionale gjatë komunikimit me kolegët dhe klientët;
- Të zbatojë Kodin e Etikës;
- Të zbatojë teknikat e duhura në menaxhimin e ankesave dhe mosmarrëveshjeve me klientët;
- Të zbatojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;

#### **Rregullat e sigurisë, shëndetit në punë, mbrojtja e mjedisit**

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të zbatojë masat për garantimin e sigurisë dhe shëndetit në shërbimet elektro-auto në mjetet e transportit;
- Të sigurojë dhe mbajë veshjen e përshtatshme dhe mjetet e mbrojtjes në punë;
- Të zbatojë rregullat për shmangien e aksidenteve kryesore që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë së kryerjes së shërbimeve elektro-auto të mjeteve të transportit;
- Të zbatojë sinjalistikën (udhëzimet, shenjat dhe simbolet e shkruara) të vendosura në mjediset e punës;
- Të zbatojë planin dhe procedurat e evakuimit në raste emergjence;

- Të zbatojë rregullat për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, kur punohet në ambientet me gaz, me energji elektrike, me materialet ndezëse (shkrepëse, çakmakë, etj)
- Të sigurojë gatishmërinë e mjeteve zjarrfikëse;
- Të përdorë mjetet zjarrfikës
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me energji elektrike;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë ngritjes dhe zhvendosjes së ngarkesave dhe peshave të rënda;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme, etj.;
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes, magazinimit dhe sigurisë në punë, gjatë punimeve me lëngje të ndryshme (vaj, alkool, lëndë djegëse, solucione kimike etj.);
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me gaz;
- Të zbatojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të sigurojë ndriçimin e duhur të mjedisit të punës;
- Të sigurojë ajrimin e duhur të mjedisit të punës;
- Të përshkruajë parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të kryejë procedurat e duhura për ndarjen e mbeturinave sipas llojit dhe depozitimin e mbetjeve nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të zbatojë rregullat përkatëse për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve;
- Të përdorë në mënyrë racionale lëndët e para mjetet dhe pajisjet e punës dhe energjinë;
- Të zbatojë masat përkatëse për ruajtjen e mjedisit;
- Të përdorë shenjat informuese të sigurimit teknik gjatë punimeve elektro-auto në çdo rast nevojë;
- Të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie;
- Të mbajë pastër vendin e punës;

## KOMPETENCA TË PËRGGJITHSHME

### Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënies të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të

nxënë gjatë gjithë jetës.

- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.